

## Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)

<b>Institucioni:</b>	Fakulteti i edukimit fizik dhe sporti dhe shendetit	
<b>Drejtimi:</b>	Bachelor	
<b>Niveli:</b>		
<b>Kodi i lëndës:</b>		
<b>Lënda:</b>	Pedagogjia në Sport	
<b>Statusi:</b>	Obligative	(Obligative)
<b>Semestri:</b>	I	
<b>Fondi i orëve:</b>	2	(Sipas programit të aprovuar)
<b>ECVET:</b>	5	(Sipas programit të aprovuar)
<b>Orari/Salla</b>		
<b>Viti akademik:</b>	2024/2025	
<b>Mësimdhënës/e:</b>	Prof. Dr. Tringa Dedi	
<b>Asistent/e:</b>		
<b>Kontaktet:</b>	Mësimdhënës/e	Asistent/e
<b>Email:</b>	tringadedi@gmail.com	
<b>Telefon:</b>	044143673/049130066	

Ky modul është dizajnuar për të pajisur kandidatët e sportit me njohuritë dhe aftësitë themelore në fushën e pedagogjisë së sportit, duke përfshirë teorinë dhe praktikën edukative. Gjatë këtij kursi, kandidatet do të fitojnë njohuri të thelluara për edukimin dhe disiplinat pedagogjike, si dhe për praktikën edukative dhe marrëdhëniet edukative.

Kandidatët:

- do të fitojnë njohuri të thella për konceptet bazë të edukimit dhe disiplinave pedagogjike, duke përfshirë praktikat dhe marrëdhëniet edukative.
- do të mësojnë për programet dhe përmbajtjen e mësimit, planifikimin e mësimit, objektivat mësimore, dhe vlerësimin në edukim,
- do të zhvillojnë aftësi për përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë karakteristikat e mësimdhënies efektive dhe të pyeturit,
- do të fitojnë njohuri themelore për stërvitjen sportive si një proces edukativ që mbështet zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit të fëmijëve dhe sportistëve,
- do të mësojnë për metodat, parimet, mjetet dhe format e edukimit intelektual, socio-moral, estetik dhe fizik përmes sportit,
- do të zhvillojnë aftësitë për zbatimin e këtyre njohurive në procesin e zhvillimit të stërvitjes sportive dhe
- do të inkurajohen të shohin stërvitjen sportive si një proces edukativ që mbështet zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve dhe sportistëve.

**PERMBAJTJE**

<b>QËLLIMI</b>	<p>Kandidatët do të përfitojnë njohuri të përgjithshme për rëndësinë e lëndës së pedagogjisë në sport. Ata do të marrin njohuri themelore për stërvitjen sportive si një proces edukativ që mbështet zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijëve dhe sportistëve.</p> <p>Gjithashtu, do të mësojnë për zotërimin e metodave, parimeve, mjeteve dhe formave të edukimit intelektual, socio-moral, estetik dhe fizik përmes sportit, si dhe për zhvillimin e aftësive për zbatimin e këtyre njohurive në procesin e stërvitjes sportive.</p> <p>Kandidatët do të përfitojnë njohuri për rolin e trajnerëve dhe drejtuesve sportivë në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, si dhe për të mësuarit efektiv në praktikë, motivimin dhe për shëndetin përmes edukimit fizik dhe sportit të të rinjve.</p>	
<b>ARRITSHMËRIA</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, kandidati do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zotërojë njohuri themelore për aspektet edukative në sport.</li> <li>• Të ketë njohuri themelore për procesin e mësimit, zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve.</li> <li>• Të kuptojë dhe zbatojë procedurat pedagogjike në stërvitjen sportive për grupmosha të ndryshme të fëmijëve dhe sportistëve.</li> <li>• Të kuptojë dhe aplikojë qasje pedagogjike në realizimin e trajnimeve sportive.</li> <li>• Të ketë njohuri për metodat efektive të të mësuarit në praktikë.</li> <li>• Të ketë njohuri për ndikimin e edukimit fizik dhe sportit në shëndetin e të rinjve.</li> <li>• Të ketë njohuri për strategjitë pedagogjike që mbështesin zhvillimin e vetë-efikasitetit në aktivitetet sportive.</li> <li>• Të kuptojë rolin e trajnerëve dhe drejtuesve sportivë në formimin dhe zhvillimin e personalitetit të fëmijëve.</li> </ul>	
<b>PROGRAMI</b>	<p><b>Javët</b></p>	<p><b>Tema</b></p>
	<p><b>Java - I</b></p>	<p><b>Prezantimi i syllabusit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti dhe lënda e pedagogjisë në sport,</li> <li>• Rëndësia e edukimit me Dimensionin European</li> <li>• Modelet e Edukimit Fizik dhe te mesuarit ne sport</li> </ul>
	<p>Java – II</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Pedagogjia e Sportit: Një Qasje Holistike për Zhvillimin e Aftësive Fizike dhe Sociale"</b></li> </ul> <p>Pedagogjia e sportit promovon një qasje holistike për zhvillimin e aftësive fizike dhe sociale, duke kombinuar stërvitjen fizike me edukimin e vlerave dhe sjelljeve pozitive. Kjo qasje ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë aftësi bashkëpunuese,</p>

		<p>përgjegjësi sociale dhe vetëbesim, ndërsa përmirësojnë shëndetin dhe performancën fizike. Përmes metodave edukative dhe trajnerëve të angazhuar, sporti shërben si një platformë për zhvillimin e plotë të personalitetit dhe mirëqenies.</p>	
	<b>Java – III</b>	<p><b>Procesi i mësimdhënies dhe të mesuarit në edukimin fizik dhe shëndetësor.</b></p> <p><i>(Metodat dhe strategjite për të efektivizuar mesimdhënien dhe të mesuarit në këtë fushë)</i></p>	
	<b>Java-IV</b>	<p><b>Objektivat e punës pedagogjike dhe konkretizimi i tyre.</b></p> <p><i>(Definimi dhe implementimi i objektivave në procesin pedagogjik dhe sportiv)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Programi dhe plani mësimor, (planifikimi i mësimit)</li> <li>• Zhvillimin e njësive mësimore dhe planet mësimore,</li> </ul> <p><i>(Hartimi i programeve dhe planeve mësimore për edukimin fizik dhe sportiv)</i></p>	
	<b>Java-V</b>	<p><b>Metodat e aktivizimit dhe strategjitë në mësimin lëvizor-qëndrimet edukative ndaj aktivitetit fizik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mësuarit efektiv në punën praktikë me fëmijë,</li> <li>• Korniza teorike e lojërave dhe garave,</li> <li>• Vlerësimi në edukim dhe të pyeturit,</li> </ul> <p><i>(Metodat dhe instrumentet për vlerësimin e performances dhe përparesive në edukimin fizik dhe sportiv)</i></p>	
	<b>Java-VI</b>	<p><b>Shpjegimet teorike të procesit mësimor dhe sjelljes sociale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukata sportive dhe morale:</li> <li>• Dilema morale në punën e trajnerëve,</li> </ul>	

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i sjelljes dhe karakterit sportiv në sport.</li> </ul> <p>Shpjegimet teorike të edukatës sportive dhe morale. (Ndikimi i edukatës sportive në zhvillimin e sjelljes dhe karakterit sportiv)</p>	
	Java-VII	<p><b>Sporti si kontekst për të mësuar sjelljen prosociale dhe parandalimin e problemeve të sjelljes së të rinjeve</b></p> <p><i>(Roli i sportit në promovimin e sjelljes pozitive dhe parandalimi i problemeve të sjelljes)</i></p>	
	Java-VIII	<p><b>Të mësuarit efektiv në praktikë</b></p> <p><i>(Të mësuarit për shëndetin përmes edukimit fizik dhe sportit të të rinjve)</i></p>	
	Java- IX	<p><b>Bashkëpunimi i trajnerëve, me institucioneve sportive, educative.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit</li> <li>Ambasadat e Kosoves</li> <li>Federatat Sportive</li> <li>Komuna e Prishtines</li> <li>FEFS-Fakulteti I Edukimit Fizik dhe Sporti</li> <li>Kolegjet: UBT dhe AAB</li> </ul>	
	Java-X	<p><b>Roli i trajnerëve dhe drejtuesve sportiv në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza e metodave dhe teknikave që trajnerët përdorin për të ndihmuar në formimin e karakterit dhe aftësive sociale të fëmijëve.</li> <li>Rëndësia e inkurajimit të cilësive pozitive si ndershmëria, respekti dhe bashkëpunimi në ambientin sportiv.</li> <li>Strategjitë që trajnerët përdorin për të ndihmuar fëmijët të menaxhojnë emocionet dhe stresin e lidhur me performancën sportive.</li> <li>Teknikat e mbështetjes emocionale dhe ndihma në zhvillimin e vetëbesimit dhe menaxhimit të stresit përmes sportit.</li> </ul>	

	<p><b>Java- XI</b></p>	<p><b>Analiza e rëndësisë së vendosjes së objektivave të qarta dhe të arritshme për rritjen e besimit dhe vetë-efikasitetit të sportistëve.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjitë për të ndihmuar sportistët të vendosin dhe arrijnë objektiva të ndarë në hapa të vegjël që kontribuojnë në ndjenjën e suksesit dhe përmirësimin e vetë-efikasitetit.</li> <li>• Eksplorimi i mënyrave për të përdorur teknikën e reflektimit dhe ofrimin e feedback-ut të ndërtueshëm për të ndihmuar sportistët të analizojnë performancën e tyre dhe të zhvillojnë besimin në aftësitë e tyre.</li> <li>• Strategjitë për ofrimin e feedback-ut që nxit zhvillimin e vetë-efikasitetit dhe ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm në aktivitetet sportive.</li> </ul>	
	<p><b>Java – XII</b></p>	<p><b>Motivimin e fëmijëve dhe adoleshentëve për të luajtur sport</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksplorimi i ndikimit të mbështetjes nga prindërit, familja dhe komuniteti në motivimin e fëmijëve dhe adoleshentëve për të marrë pjesë në aktivitete sportive.</li> <li>• Analiza e ndikimit të trajnerëve, mentorëve dhe liderëve të grupit në motivimin e të rinjve për të angazhuar në sport dhe krijimin e një ambienti të nxitjes dhe mbështetjes.</li> <li>• Fëmijët shpesh ndjehen të motivuar nga shembujt e suksesit dhe modelet si trajnerët, mentorët dhe sportistët e famshëm që tregojnë përfitimet dhe kënaqësinë e angazhimit në sport.</li> <li>• Fëmijët shpesh janë më të motivuar të angazhohen në sport kur aktivitetet janë të ndryshme, argëtuese dhe krijuese, duke i bërë ato të dukshme dhe tërheqëse.</li> <li>• Vendosja e qëllimeve personale dhe përballja me sfida që janë të përshtatshme për nivelin e tyre të aftësive ndihmon në rritjen e motivimit dhe përkushtimit të fëmijëve.</li> </ul>	
	<p><b>Java – XIII</b></p>	<p><b>Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, zhvillimi social në pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në sport</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e Rëndësisë së Interaksionit dhe Bashkëpunimit në Aktivitetet Sportive: Si ndihmon ndërveprimi me bashkëmoshatarët dhe ndihma e ndërsjellë në ndërtimin e aftësive sociale si komunikimi, ndihma dhe respekti.</li> <li>• Roli i Sporteve të Grupi në Formimin e Miqësive dhe Forcimin e Marrëdhënieve Sociale: Si pjesëmarrja në sportet e grupit kontribuon në zhvillimin e miqësive,</li> </ul>	

		krijimin e lidhjeve sociale dhe ndihmon në ndërtimin e një ndjenje përkatësie dhe bashkëpunimi.	
	<b>Java- XIV</b>	<p><b>Problemet pedagogjike të një grupi sportiv, stilet e menaxhimit të një grupi sportiv, parimet e komunikimit të suksesshëm.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi dhe Zgjidhja e Problemeve Pedagogjike në Grupet Sportive: Analiza e problemeve të zakonshme pedagogjike që mund të shfaqen në grupet sportive, si mosmarrëveshjet, konflikti dhe ndjenjat e përjashtimit, dhe strategjitë për t'i adresuar ato në mënyrë efektive.</li> <li>• Zbatimi i Stileve të Menaxhimit dhe Komunikimit të Suksesshëm në Grupet Sportive: Diskutimi i stilit të menaxhimit të përshtatshëm për grupet sportive, si autoritar, demokratik dhe laissez-faire, dhe rëndësia e përdorimit të parimeve të komunikimit të hapur dhe ndihmues për të mbështetur bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në grup.</li> </ul>	
	<b>Java – XV</b>	<p><b>Modelet e trajneri të suksesshëm në sporte të ndryshme.</b></p> <p><i>(Praktikë e bazuar në model: strukturimi i teknikës dhe stërvitjes për të përmbushur nevojat e ndryshme të të mësuarit)</i></p>	
<b>LITERATURA</b>	<p><b>Literatura themelore:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A, Skathleen. (2013). <i>Sport Pedagogy, An Introduction for Teaching and Coaching, Published 2013 by Routledge</i></li> <li>2. Berry, A. (2007). <i>Tensions in teaching about teaching: Understanding practice as a teacher educator. Dordrecht, The Netherlands:</i></li> <li>3. Springer. Bullough, R. V. J., &amp; Pinnegar, S. (2001). <i>Guidelines for quality in autobiographical forms of self-study research. Educational Researcher, 30(3), 13–21</i></li> <li>4. Dinan, M. (2001) Teachers facing health and physical education curriculum changes: a kaleidoscope of beliefs, values, emotions and interactions, <i>The ACHPER Healthy Lifestyles Journal, 48(1), 9–12.</i></li> <li>5. Armour, K. (2011). <i>Sport Pedagogy: An introduction for coaching and teaching. London: Pea</i></li> </ol>		

**METODOLOGJIA E  
MËSIMDHËNJËS**

Mësimi do të organizohet dhe zhvillohet përmes ligjëratave teorike. Gjatë ligjëratave teorike do të punohet në mënyrë interaktive, ku studentët do të jetë pjesëmarrës aktiv duke i shfaqur diturit e tyre, komentet, sugjerimet dhe pyetjet.

Ligjërata teorike, ushtrime në praktikë, konsultime , diskutime, punë individuale, punë në grupe me metoda interaktive

Ligjëratë-diskutim analizë, ushtrime, prezantime nga hulumtimet për trendet bashkëkohore, punë individuale dhe grupore, etj.

**Kushtet materiale:**

- Burimet e klasës dhe didaktike që nevojiten për performancën e së tërës (prezantime, fotografikë, diagrame, kompjuter, projektor)

Kontributi në ngarkesën e kandidatët (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECVET kredi = 20 orë)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata Teorike	2	15	30
Ushtrime praktike			
Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	15	15
Detyra të pavarura	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	3	3
Projektet, prezantimet , etj	1	15	15
<b>Totali</b>			<b>108</b>

**Vlerësimi:** Puna e studentëve përcillet me vëmendje gjatë tërë organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor. Caktohen kriteret për vijueshmëri të rregullt dhe rregullat e mirësjelljes gjatë organizimit të mësimt.

Në planifikimin e metodologjisë së vlerësimit për një modul në pedagogjinë sportive, mund të përfshihen disa elemente kryesore për të vlerësuar performancën dhe angazhimin e kandidatëve:

**Kriteret e Vlerësimit:** Pjesëmarrja aktive në klasë, ndjekja e rregullt e ligjëratave dhe kontribuimi në diskutime.

**Planifikimi:** Regjistroni vijueshmërinë e kandidatëve dhe vlerësoni angazhimin e tyre në bazë të pjesëmarrjes dhe kontribuimit në aktivitetet e klasës.

**Metodat e Vlerësimit:** Përdorni lista të kontrollit të vijueshmërisë dhe të dhënat e pjesëmarrjes për të vlerësuar përfshirjen dhe angazhimin.

**Kriteret e Vlerësimit:** Njohuritë teorike, kuptimi i konceptëve dhe aplikimi i njohurive në situata praktike.

**Planifikimi:** Organizoni kollokiume dhe teste për të matur njohuritë dhe kuptimin e materialit të mbuluar.

**Metodat e Vlerësimit:** Teste me pyetje të shumëfishta, pyetje të hapura dhe probleme praktike për të vlerësuar thellësinë e kuptimit dhe aplikimin e njohurive.

**Kriteret e Vlerësimit:** Aktiviteti dhe interaktiviteti i kandidatëve gjatë mësimt, përfshirja në aktivitete grupore dhe ndihma ndaj bashkëstudentëve.

**Planifikimi:** Ndjekja e aktiviteteve dhe kontribuimeve të kandidatëve gjatë ligjëratave dhe diskutimeve grupore.

**Metodat e Vlerësimit:** Vlerësimi i angazhimit përmes vëzhgimeve të drejtpërdrejta dhe diskutimeve për të matur sa mirë kandidatët janë të angazhuar në mësim.

**Kriteret e Vlerësimit:** Kualiteti i kërkimeve, qartësia e prezantimeve, aftësia për të argumentuar dhe mbrojtur idetë dhe zbatimin e metodologjisë së kërkuar.

**Planifikimi:** Caktoni datat për dorëzimin e projekteve dhe prezantimeve, dhe ofroni udhëzime të qarta për përmbajtjen dhe formatin.

**Metodat e Vlerësimit:** Vlerësimi i projektit dhe prezantimeve duke përdorur një grilë vlerësimi që përfshin kriteret si përmbajtja, organizimi, dhe aftësia për të komunikur efektivisht.

**Kriteret e Vlerësimit:** Bashkëpunimi në grup, përmbushja e detyrave dhe angazhimi në projekte praktike.

**Planifikimi:** Caktoni projekte dhe aktivitete grupore që kërkojnë bashkëpunim dhe ndihmën e kandidatëve për të zhvilluar aftësi praktike dhe të grupit.

**Metodat e Vlerësimit:** Vlerësimi i performancës së grupit dhe individëve në projekte dhe aktivitete, duke përdorur kriteret e vlerësimit për të matur kontribuimin dhe rezultatin final.

**Kriteret e Vlerësimit:** Rëndësia e feedback-ut konstruktiv dhe përmirësimeve të vazhdueshme.

**Planifikimi:** Organizoni seanca të rregullta të feedback-ut për studentët për të diskutuar rezultatet dhe për të ofruar rekomandime për përmirësim.

**Metodat e Vlerësimit:** Përdorni formularë të feedback-ut dhe biseda individuale për të ndihmuar studentët të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta në performancën e tyre.

*Përmbledhje*

*Vijueshmëria dhe Pjesëmarrja në Ligjërata*

*Kollokiumet dhe Testet*

*Angazhimi në Klasë*

*Përgatitja dhe Prezantimi i Projekteve dhe Detyrave*

*Pjesëmarrja në Aktivitetet e Grupit dhe Projekteve Praktike*

*Feedback dhe Rishikimi i Performancës*

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi praktik 30 %(Projektet dhe detyrat)

Vlerësimi teorik 60 % (Kollokiumet)

Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim 10 %

<b>Nota</b>	<b>ECV ET nota</b>	<b>Suksesi pikë - %</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>10</b>	<b>A</b>	<b>91 – 100 %</b>	<b>SHKËLQYESHËM</b> – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
<b>9</b>	<b>B</b>	<b>81 – 90 %</b>	<b>SHUMË MIRË</b> – arritje mbi mesatare, por me disa gabime
<b>8</b>	<b>C</b>	<b>71 – 80 %</b>	<b>MIRË</b> – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
<b>7</b>	<b>D</b>	<b>61 – 70 %</b>	<b>KËNAQSHËM</b> – mirë, por me mjaftë gabime
<b>6</b>	<b>E</b>	<b>51 – 60 %</b>	<b>MJAFTON</b> – rezultatet plotësojnë kriteret minimale
<b>5</b>	<b>F</b>	<b>40 – 50 %</b>	<b>DOBËT</b> – kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kredit
<b>4</b>	<b>G</b>	<b>00 – 39 %</b>	<b>DOBËT</b> – kërkohet shumë punë për të fituar kredit.

**VLERËSIMI**

--	--

**Prishtinë 26.8.2024**

**Bartës/e i/e lëndës:**

**Dr.Sc.Tringa DEDI**